

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2024

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1.	05.02.2024	Pershendetje, jam e intresuar per kurs piktore ose piano per djalin 4 vjec e gjys, mundem nj info per gjestrimin / Faleminderit ***	07.02.2024	Pershendetje, ju informojme se kurset e artit zhvillohen per te gjithë femijet e moshes 6-14 vjec. Ju falenderojme per mirekuptimin !	E plote	Nuk ka
2.	08.02.2024	1. Mirdita, a ka ne program shfaqje per datat 11 e 12 shkurt? faleminderit 2. Faleminderit per pergjigjen, sa zgjat spektakli dhe a ka nevoj te prenotoj biletat?? Diten e mir!!	08.02.2024	1.Pershendetje, programi i shfaqjeve te Teatrit te kukullave ne vijim eshte : Këtë fundjavë në sallën "Tonin Harapi" në Liceun artistik "Jordan Misja" do të ndiqni shfaqjen "Mister Stetoskopi" E shtunë 10 Shkurt- 10:30, 11:30, E Dielë 11 Shkurt -10:30, 11:30. Data 12 shkurt eshte e hene dhe nuk zhvillohen shfaqje. Jeni te mirepritur ne teater ! 2. Shfaqja "Mister Stetoskopi" zgjat 30 min, ju njoftojmë se biletat mund të tërhiqen vetëm pranë Liceut artistik "Jordan Misja" cdo të shtunë dhe të diel nga ora 09:00-12:00. Nr. Cel 0694466699. Nese deshironi mund te prenotoni biletën ose mund ta blini ne receptionin e salles "Tonin Harapi" ne Liceun Artistik "Jordan Misja" ditën kur zhvillohet shfaqja. Faleminderit per mirekuptimin !	E plote	Nuk ka
3.	20.02.2024	1.Pershendetje,jam e interesuar per vajzen time 6 vjec e gjys, per ta regjistruar prane qendres tuaj! Si duhet te veproju lutem?	20.02.2024	Pershendetje, ju falenderojme per interesimin e shprehur! Ju informojme se aktualisht ne Qendren tone kemi vende te lira per regjistrime ne kurset e artit ne deget e aktrimit, kenges dhe kostumografi/skenografi. Jeni te mirepritur !	E plote	Nuk ka

		2. Po pagesa si varjon ju lutem?		Adresa :Rruga Gezim Erebara, (prane ish Kinostudios). 2. Pershendetje, ju informojme se per sa i perket tarifes per kurset e artit, kryhet vetem pagesa per regjistrimin per kursin perkates. Tarifa eshte 1500 leke. Faleminderit per mirekuptimin !		
4.	07.03.2024	Pershendetje, Doja te shikoja shfaqjen e tre derrkucave. A mund te me informoni nese do shfaqet dhe kur. Ju faleminderit.	11.03.2024	Pershendetje, ju informojme se shfaqja "Tre derrkucët" eshte dhënë vetem pak javë më parë, nuk e kemi parashikuar per ta dhene deri ne fund te sezonit artistik. Megjithate ju sygjerojme qe te na ndiqni periodikisht ne faqen tone ne Facebook dhe instagram per tu azhornuar mbi shfaqjet qe do te jepen ne Teatrin e Kukullave. Ju falenderojme per mirekuptimin !	E plote	Nuk ka
5.	18.03.2024	Pershendetje, doja te dija a ofrohet ndonje shfaqje te dielen me daten 24.03.? Nqs. po ne cilen ore? Flm. per pergjigjen.	19.03.2024	Pershendetje, ju informojme se këtë fundjavë ne Sallën "Tonin Harapi" ne Liceun artistik "Jordan Misja" do të ndiqni: Shfaqja "Djali Miliarder" 23 Mars , E Shtunë Ora 10 : 30 ,11 : 30 24 Mars , E Dielë Ora 10 : 30 ,11 : 30 Ju njoftojmë se biletat mund të tërhiqen vetëm pranë Liceut artistik "Jordan Misja" çdo të shtunë dhe të diel nga ora 09:00-12:00. Nr. Cel 0694466699,Çmimi i biletës : 100 Lek Ju falenderojmë per mirëkuptimin.	E plote	Nuk ka
6.	25.03.2024	Pershendetje! Nepermjet ketij emaili kerkojme nje informacion nga ana juaj mbi oraret dhe cmimin e shfaqjeve qe do te zhvillohen ditën e merkure date 27 mars, ne tetarin per femije.	26.03.2024	Pershendetje, ju falenderojme per interesimin e treguar ! Ju njoftojme se neser me date 27 mars teatri i kukullave zhvillon nje workshop me tematike "Teatri i kukullave" ku mund te merrni pjese duke qene se hyrja eshte e lire (pa pagese), event i zhvillohet ne Parkun e madh te liqenit artificial ne oren 10 : 30. Per sa i perket zhvillimit te nje shfaqje me kukulla ju njoftojme se	E plote	Nuk ka

		<p>Behet fjale per nje grup prej 15-20 femijesh, te moshes 5-6 vjeç, te kopshtit publik nr.6 Tirane, ku ne kuader te Dites Boterore te Teatrit do donim te ndiqnim nje shfaqje!</p> <p>Duke ju falenderuar per mirekuptimin!</p> <p>Me respekt, ***** *****</p> <p>Kopshti publik Nr.6 Tirane</p>		<p>shfaqja e radhes zhvillohet ditën e enjte me date 28 mars ne qendren "Kristal", per informacione te metejshme gjithashtu ne rast se deshironi te prenotoni per kopeshtin tuaj mund te kontaktoni personin qe eshte e angazhuar me kete pjese, Klaudia Hila, cel. 0696126631.</p> <p>Jeni te mirepritur ne Teater</p>		
7.	10.04.2024	<p>Good morning.</p> <p>We are visiting Tirana this week. Do you have any shows happening?</p> <p>Thank you ****</p>	12.04.2024	<p>Hello,</p> <p>We inform you that in the "Tonin Harapi" Hall at the artistic high school "Jordan Misja" you will attend:</p> <p>The puppet show "Cinderella" April 13, Saturday, 10:30, 11:30 April 14, Sunday, 10:30, 11:30</p> <p>We inform you that tickets can only be picked up near the Artistic High School "Jordan Misja" every Saturday and Sunday from 09:00-12:00. Cell 0694466699,ticket price: 100 Lek.</p> <p>Thank you for your understanding.</p>	E plote	Nuk ka
8.	03.05.2024	<p>Përshëndetje!</p> <p>Jam Ledian Gjeçi, konkurent në audicionin për "Aktor i parë" sot më datë 03.05.2024, pranë "Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, Teatri i Kukullave."</p> <p>Pas përfundimit të audicionit jam informuar me telefon nga Z. Nelson Mulla (anëtar i komisionit vlerësues) se pozicionin si "Aktor i</p>	08.05.2024	<p>I nderuar Z. Gjeçi,</p> <p>Ju vendosim në dispozicion sipas kërkesës tuaj si pala e interesuar, dokumentacionin në lidhje me procedurën e përzgjedhjes së pozicionit "Aktor i Parë", si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Relacion për ngritjen e komisionit të posaçëm "Ad-hoc" që do të kryejë vlerësimin artistik në audicionin e kandidaturave për vendin vakant "Aktor i Parë". 2. Proces-verbal pas përfundimit të vlerësimit artistik të audicionit të kandidaturave për vendin vakant "Aktor i Parë". 	E plote	Nuk ka

		<p>parë" e ka fituar Z. Erdit Asllanaj.</p> <p>Ju informoj paraprakisht se e kundërshtoj vendimin e jurisë, për arsye mosmarrjeje në konsiderate të CV, dhe për konflikt interesi midis palëve, të cilën do e sqaroj zyrtarisht në vijim të proçedurës...</p> <p>Ky email ka qëllim informues për arsye dokumentacioni. I adresohet për dijeni Drejtorit të "Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, Teatri i Kukullave." Z. Agim Bajko, gjithashtu edhe anëtarëve të komisionit: Z. Milto Kutali Znj. Shegushe Bebeti Z. Nelson Mulla Z. Fatjon Sulstarova Znj. (Anëtares së jurisë nga Ministria Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.)</p> <p>2. Përshëndetje!</p> <p>Në vijim të komunikimit të mëparshëm, kërkoj të më vini në dispozicion:</p> <ul style="list-style-type: none"> •Vendimin e komisionit për fituesin, sëbashku me arsyetimin. •Vendimin e drejtorit të "Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, Teatri i 		<p>3. Urdhër emërimi në detyrë "Aktor i Parë".</p> <p>Ditë të mbarë!</p>		
--	--	---	--	--	--	--

		<p>Kukullave." Z. Agim Bajko, për punësimin e aktorit fitues.</p> <ul style="list-style-type: none"> •Videoregjistrimin e gjithë audicionit, me të gjithë konkurentët. •CV-të e konkurentëve. •Dhe çdo dokumend tjetër mbështetës. <p>Me këtë kërkesë ju drejtohem në cilësinë e konkurentit në audicionin për 'Aktor i parë' që u zhvillua në datë 03.05.2024 në "Qendren Kombëtare të Kulturës për fëmijë".</p>				
9.	03.05.2024	<p>Pershendetje. Dua te aktivizoj vajzen time 9 vjec te qendra per femije. Keni vende te lira? Faleminderit. ****</p>	07.05.2024	<p>Pershendetje, ju njoftojme se regjistrimet ne kurset e artit te QKKF rifillojne ne muajin shtator, jeni te mirepritur !</p>	E plote	Nuk ka
10.	17.05.2024	<p>Pershendetje, Ju lutem a mund te na informoni cfare shfaqje ka neser dhe pasneser ne teatrin e kukullave dhe orarin? Ne pritje te pergjigjes tuaj. Gjithe te mirat!</p>	17.05.2024	<p>Pershendetje, ju informojme se kete fundjave (data 18-19 maj 2024) do te jete programi ne vijim : Vetëm këtë të dielë në Sallën "Tonin Harapi" në Liceun artistik "Jordan Misja" do të ndiqni: Shfaqja "Vitaminat e Jetës" 19 Maj , E Dielë, Ora 10 : 30 , 11 : 30 Ju njoftojme se ditën e shtunë (data 18 maj 2024) nuk do të zhvillohet shfaqje në sallën "Tonin Harapi" në Liceun Artistik "Jordan Misja". Duke ju falenderuar për mirekuptimin ! Gjithe te mirat.</p>	E plote	Nuk ka
11.	17.05.2024	<p>Pershendetje si jeni mir ?</p>	21.05.2024	<p>Pershendetje, ju falenderojme per interesin e shprehur, ju informojme se Qendra</p>	E plote	Nuk ka

		Ju shkruaj per t'ju pyetur nese te shtunen 1.qershor. mendoni te ofroni nje shfaqje/spektakel per femije? Ne do te kishim shume deshire te sillnim disa femije, nese kushtet do jene te pershtatshme.		Kombetare e Kultures per femije do te zhvilloje nje koncert ne amfiteatrin e parkut te madh te liqenit artificial si dhe nje sfilate te titulluar "Ne riciklojme" ne COD Kryeministria ne oren 11 : 00, ndersa teatri kukullave do te zhvilloje shfaqjen premiere "Tre Muskëterët" ne qendren "Kristal". Ju ftojme te na ndiqni ne rrjetet sociale Instagram dhe Facebook per tu azhornuar me te gjitha shfaqjet/aktivitetet qe organizon Qendra Kombetare e Kultures per Femije, Teatri i Kukullave. Jeni te mirepritur, gjithë te mirat !		
12.	18.05.2024	Ne cilat data eshte shfaqja macoku me çizme?	21.05.2024	Pershendetje, ju informojme se shfaqja "Maçoku me çizme" nuk eshte parashikuar te jepet gjate muajit maj, shfaqjet ne vijim qe do te jepen ne sallën "Tonin Harapi"ne Liceun artistik "Jordan Misaja" do te jene : Premiera" Tre Muskëterët", 25-26 maj, 1-2 qershor. Jeni te mirepritur ne teater ! Gjithe te mirat !	E plote	Nuk ka
13.	24.05.2024	Pershendetje, Ju lutem per nje informacion. Kam vajzen 7 vjec dhe jam e intersuar per ta rregjistruar ne nje nga 2 kurset: 1. Këngë, Kori i fëmijëve 2. Piano Kur jane rregjistrimet e hapura? Oraret e frekuentimit dhe detaje te tjera. Faleminderit	24.05.2024	Pershendetje, ju falenderojme per interesin e shprehur. Ju informojme se kurset e artit ne Qendren Kombetare te Kultures per Femije rifillojne ne muajin shtator 2024, ju mirepresim per regjistrime. Gjithe te mirat !	E plote	Nuk ka
14.	04.06.2024	Përshëndetje, Unë jam ***** dhe	05.06.2024	Pershendetje *****, Ju falenderojme per interesimin e treguar, regjistrimet per kurset e	E plote	Nuk ka

		<p>kam vajzë ***** të moshës 6 vjeç. Dëshiroj të regjistroj vajzën time në qendrën kulturore për fëmijë.</p> <p>Jam e interesuar për programet dhe aktivitetet që ofron qendra juaj, dhe besoj se do të jetë një përvojë e vlefshme për vajzën time.</p> <p>Ju lutem më informoni për procesin e regjistrimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për të plotësuar. Nëse ka afat të caktuar për regjistrimin.</p> <p>Ju falënderoj për kohën tuaj në pritje të përgjigjes suaj.</p> <p>Me respekt, *****</p>		<p>artit ne qendren tone fillojne ne muajin shtator. Kurset zhvillohen 2 here ne jave. Kurset e artit jane : balet, aktrim,kenge, piktore, kostumografi/skenografi, piano, violine. Pagesa eshte 1500 leke per regjistrim dhe kursi eshte falas nga muaji shtator deri ne qershor. Aktivitetet qe zhvillohen jane koncerte, ekspozita, festivale qe zhvillohen pergjate kesaj periudhe. Oraret e kurseve jane te ndryshme ne varesi te grupmohave te femijeve. Ju mirepresim !</p>		
15.	13.06.2024	<p>Pershendetje, Doja te dija a ka keto dite shfaqje ne Tirane?</p> <p>Gjithe te mirat!</p>	14.06.2024	<p>Pershendetje, ju falenderojme per interesin e treguar per te ndjekur shfaqjet e teatrit te kukullave! Ju informojme se teatri i kukullave ka mbyllur sezonin artistik per shfaqjet gjate javes dhe ne fundjave per publikun e gjere duke qene se ka nisur dhe tourin veror 2024. Megjithate duke qene se aktualisht teatri po pergatit nje premiere te re qe do te jete pjese e tourit veror mund te krijojme mundesine per ta shfaqur kete premiere dhe ne Tirane, ne sallën "Tonin Harapi" ne Liceun artistik "Jordan Misja" ose ne skenen e qendres "Kristal".</p>	E plote	Nuk ka

				Do tju njoftojme shume shpejt per daten dhe oren. Gjithe te mirat !		
16.	18.06.2024	Mirëdita, A ka shfaqje këto ditë gjatë javës dhe nëse po, ju jeni? Afër liceut? Faleminderit	20.06.2024	Pershendetje, ju falenderojme per interesin e treguar per te ndjekur shfaqjet e teatrit te kukullave! Ju informojme se teatri i kukullave ka mbyllur sezonin artistik per shfaqjet gjate javes dhe ne fundjave per publikun e gjere duke qene se ka nisur dhe tourin veror 2024. Megjithate duke qene se aktualisht teatri po pergatit nje premiere te re qe do te jete pjese e tourit veror ju njoftojme se kjo premiere do te jepet ne skenen e qendres "Kristal" dite e premte 21 qershor ne oren 10 : 30. Hyrja eshte e lire, jeni te mirepritur. Gjithe te mirat !	E plote	Nuk ka
17.	22.07.2024	Pershendetje, kur hapen kurset apo regjistrimet per kenge?	29.07.2024	Pershendetje, ju njoftojme se kurset e artit ne Qendren Kombetare te Kultures per femije hapen ne muajin shtator, jeni te mirepritur per regjistrime. Gjithe te mirat !	E plote	Nuk ka
18.	27.07.2024	Pershendetje. Po shikoja ne faqen e teatrit te kukullave dhe nuk po gjeja mjaftueshem informacione mbi oraret dhe shfaqet qe do jene ne vazhdim. Ka ndonje vend kur publikoni shfaqet dhe oraret? Gjithe te mirat, ****	29.07.2024	Pershendetje, ju njoftojme se aktualisht teatri i kukullave zhvillon shfaqjet ne gjithe Shqiperine duke qene pjese e turit veror 2024. Ju njoftojme se shfaqjet qe zhvillohen gjate fundjaves per publikun e gjere te Tiranes fillojne ne muajin shtator. Shfaqjet se bashku me oraret dhe vendodhjet ne vijim qe jane dhe pjese e turit do te jene keto ne vijim : “Smërfët dhe Gargamela” Shfaqje teatrale me kukulla per femije: Parku qendror, Fier 6 Gusht 20 : 00 Parku “Aqif Pasha” Elbasan 13 Gusht 20 : 00 Sheshi qendror, Gramsh 17 Gusht 20 : 00 Sheshi perpara Teatrit ”Aleksander Moisiu” Durrës 27 Gusht 20	E plote	Nuk ka

				: 00 Gjithashtu ju njoftojme se ne faqen tone ne Facebook dhe Instagram postojme rregullisht njoftime per zhvillimin e shfaqjeve dhe aktiviteteteve te ndryshme kulturore. Gjithe te mirat !		
19.	28.07.2024	Pershendetje, A keni shfaqje aktive per momentin? ****	29.07.2024	Pershendetje, ju njoftojme se aktualisht teatri i kukullave zhvillon shfaqjet ne gjithe Shqiperine duke qene pjese e turit veror 2024. Ju njoftojme se shfaqjet qe zhvillohen gjate fundjaves per publikun e gjere te Tiranes fillojne ne muajin shtator. Shfaqjet se bashku me oraret dhe vendodhjet ne vijim qe jane dhe pjese e turit do te jene keto ne vijim : “Smërfët dhe Gargamela” Shfaqje teatrale me kukulla per femije: Parku qendror, Fier 6 Gusht 20 : 00 Parku “Aqif Pasha”Elbasan 13 Gusht 20 : 00 Sheshi qendror, Gramsh 17 Gusht 20 : 00 Sheshi perpara Teatrit ”Aleksander Moisiu” Durrës 27 Gusht 20 : 00 Gjithashtu ju njoftojme se ne faqen tone ne Facebook dhe Instagram postojme rregullisht njoftime per zhvillimin e shfaqjeve dhe aktiviteteteve te ndryshme kulturore. Gjithe te mirat !	E plote	Nuk ka
20.	27.08.2024	Pershendetje, Pashe njoftimin tuaj per kurset e artit dhe dua te marr me shume informacion lidhur me kurset dhe me specifikesht per kursin e pianos. Vajza ime aktualisht ka 1 vit qe ndjek leksione piano privatisht, dhe doja te	27.08.2024	Pershendetje, ju faleminderit per interesimin. Lidhur me informacionin e kerkuar per kursin e pianos ju bejme me dije se : Kursi i pianos zhvillohet 2 here ne jave, mesuesit e pianos jane z. Alfons Zgjana dhe znj. Denisa Hasimi. Pagesa e kursit eshte 1,500 leke per te gjithë vitin mesimor shtator 2024- qershor 2025. Kursi i pianos eshte individual dhe zgjat 30 min dhe ne program perfshihet edhe solfezhi.	E plote	Nuk ka

		<p>regjistroja ne kursin tuaj.</p> <p>Sa here ne jave zhvillohet, a permban programi edhe solfezh, cilet mesues japin leksione, sa zgjat ora e kursit, a jane klasat personale apo ne grup?</p> <p>Gjithashtu si procedohet per tu regjistruar?</p> <p>Faleminderit!</p> <p>Me respekt, *****</p>		<p>Me date 2 shtator fillojme regjistrimet dhe duhet te kontaktoni me mesuesin per te perzgjedhur orarin qe ju pershtatet. Ju mirëpresim!</p>		
--	--	---	--	---	--	--